



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.12, datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE
INERTE OË NXIRREN NGA SHTRATI I LUMIT FAN, SUBJEKTIT
“PE-VLA-KU” SH.P.K**

Në mbështetje të shkronjës të pikës 2 të nenit 50 , të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar , vendimit nr.550 datë, 15.07.2020 “*“Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje,veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese,të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”*, sidhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit me nr.1 prot., datë 7.7.2011, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr.2 prot., datë 27.7.2012, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I.

1. Miratimin e lejes për shfrytëzimin e materialeve inerte, subjektit “PE-VLA-KU” sh.p.k. për zbatimin e Kontratës “Ndërtimi i Unazës së Jashtme Tiranë, Loti 4”, me vendndodhje, në shtratin e lumit Fan, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë sipas këtyre

koordinatave në sistemin KRRGJSH:

2. Treguesit paraprak të shfrytëzimit janë:

Zona e shfrytëzimit në sistemin KRRGJSH:

X1 = 481278.7	Y1 = 4620943.6	Z1 = 31 m.m.n.d
X2 = 481589.9	Y2 = 4620837.1	Z2 = 28.2 m.m.n.d
X3 = 481652.8	Y3 = 4621194.9	Z3 = 31.4 m.m.n.d
X4 = 481326.5	Y4 = 4621221.1	Z4 = 31.3 m.m.n.d

3. Sasia e dhënë në përdorim për të gjithë periudhën e lejes është jo më shumë se 125,000 m³;

4. Subjekti të respektojë të gjitha sygjërimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;

5. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU Ishëm-Erzen-Mat për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;

6. Të ndiqet nga ZABU Ishëm-Erzen-Mat zbatimi i projektit të rehabilitimit;

7. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;

8. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin ekëtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KESHILLIT
GJERGJ PRENDE

